



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Legjislatura III

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,  
Personat e Pagjetur dhe Peticione  
Mbledhja nr. 14  
Prishtinë, më, 1. 7. 2008 orën 9,00  
Nr. 0-14  
Ndërtesa e kuvendit , salla N-225

**P R O C E S V E R B A L**

i mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione.

Organizimin e këtij takimi koordinohet nga Agjencia për Integritet Evropian në bashkëpunim me Zyren Ndërlidhëse të Komisionit Evropian në Prishtinë.

**Të pranishëm:**

Komisioni për Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione i Kuvendit të Republikës së Kosovës, i kryesuar nga Ismet Beqiri, kryetar, Radmila Vujoviq, zëvendëskryetare e parë dhe Ibrahim Makolli anëtar.

**Rrahim Demaj** nga stafi mbështetës i Komisionit.

**Morën pjesë**

Rita Tophorn - eksperte e të drejtave të njeriut dhe për barazi gjinore,  
Arnaud Apprion - ekspert nga Komisioni Evropian,  
Albinot Bimbashi - zyrtar për çështje integrimi në Qeverinë e Kosovës.

Mbledhjen e kryesoi Ismet Beqiri kryetar i Komisionit

Për këtë mbledhje është propozuar ky:

R e n d d i t e

- 1. Vlerësimi i të arritjeve në lëmin e të drejtave të njeriut ,dhe të barazisë gjinore.**

Misioni vlerësues i BE-së lidhur me mbajtjen e takimit ka dy qëllime:

Vlerësimin e arritjeve në këtë lëmi që kontribuojnë për raportin e progresit evropian për vitin 2008. Zyra përkatëse e Prishtinës është duke punuar në këtë drejtim dhe ofron ndihmë dhe lehtësi për Zyrën Ndërlidhëse të Komisioni Evropian për identifikimin e fushave për të cilat mund të ofrohet ndihmë nga IPA (Instrumenti i Asistencës Para Anëtarësimit) 2009.

**Ismet Beqiri** – I përshëndeti dhe shkurtimisht i njoftoi mysafirët për fushëveprimin e Komisionit. Ua përkujtoi se Kushtetuta e Republikës së Kosovës komuniteteve ua garanton mbrojtjen e të drejtave. Komisioni mban mbledhje të rregullta si dhe dëgjime publike për shqyrtimin e peticioneve, si dhe e monitoron zbatimin e ligjeve nga Qeveria konform rregullës 53 të Rregullores së punës së Kuvendit, pa i përjashtuar nismat legislative për hartimin e projektligjeve. Informon se nga Ministria e Drejtësisë kërkohet përshpejtimi i Projektligjit për personat e pagjetur.

**Arnaud Apprion** – Njoftoi shkurtimisht për punën që është duke e bërë në BE në Bruksel dhe shtoi: Kërkohet që të hartohet raporti vlerësues në të cilin do të identifikohen se cilat grupe janë të rrezikuara për të cilat kërkohet mbështetje nga **IPA (Instrumenti i Asistencës Para Anëtarësimit) 2009**.

**Rita Tophorn** – Eksperte e të drejtave të njeriut dhe për barazi gjinore duke u ndërlidhur me parafolësin ceku si ishte më parë Kosovë në vitet 200-2003 në mbështetje të Kuvendit të Kosovës në kuadër të OSBE-së. Vërejti se kishte përparim në të gjitha fushat, por në veçanti në barazinë gjinore, meqë ekziston Ligji për barazi gjinore. Lidhur me veprimtarinë e Komisionit, pasi është i ngarkuar, ishte e mendimit të jenë vetëm dy fusha.

**Ibrahim Makolli** - Duke u ndërlidhur me parafolësit për fushat e Komisionit, theksoi se të gjitha janë të lidhura njëra me tjetrën dhe hyjnë në kuadër të të drejtave të njeriut. Duke folur për ngarkesën e zyrave tha se është bërë për plotësimin e vendeve të punës e jo për të bërë punë efikase. Mungonte bashkëpunimi që u bë pengesë për ushtrimin e veprimtarisë së tyre. Ishte i mendimit se për gjendjen e krijuar, lidhur me këtë tani nuk po funksionojnë dhe nuk po bashkëpunojnë ndërmjet vete, si në nivelin qendror dhe lokal, e fajëson OSBE-në.

**Rita Tophorn** - Pyeti sa u ofron Komisioni Parlamentar mbështetje financiare zyrave për të drejtat e njeriut dhe për barazi gjinore të Qeverisë së Kosovës? Kërkoi informata për vonesën e emërimit të drejtorit të Agjencisë për Barazi Gjinore dhe të Avokatit të Popullit?

**Ismet Beqiri** – Theksoi: Komisioni Parlamentar i mbështet zyrat përkatëse dhe jemi në kontakt t’i koordinojmë veprimet në fushat përkatëse. Gjithashtu kemi bashkëpunim me Avokatin e Popullit dhe me shoqërinë civile. Për ekspertët, tha se, për fushën e të drejtave të njeriut e kemi z. Makolli, ndërsa për fushën e të drejtave civile prof. dr. Nerxhivane Dauti.

**Radmilla Vujoviq** – I përshëndeti të pranishmit dhe shkurtimisht i njoftoi mysafirët për punën e Komisionit dhe u pajtua me diskutimet e z. Beqiri dhe Makolli sa i përket veprimtarisë së Komisionit dhe u pajtua se Komisioni është i ngarkuar me punë.

Kuvendi i Kosovës i ka plotësuar kriteret e përfaqësimit të grave, ndërsa Qeveria dhe ministrinë nuk i kanë respektuar kuotat e pjesëmarrjes së femrave në vendimmarrje të parapara me standartet evropiane.

**Arnaud Apprion** – Sërish kërkoi më shumë informata për dhunën familjare? Pyeti për mangësinë e ligjeslacionit përkatës për të drejtat e njeriut? Ai cekur se në fushën e barazisë gjinore ka përparim jo vetëm në Kuvendin e Republikës së Kosovës, por edhe te institucionet e tjera. Pastaj pyeti sa mbështeten ato politikisht dhe ekonomikisht etj.?

**Ismet Beqiri** – Kërkoi nga mysafirët të mos politizohen disa çështje, siç është rasti Avokatit të Popullit, që ka mbetur i pazgjidhur nga mandati kaluar dhe i Agjencisë për Barazi Gjinore.

**Radmilla Vujoviq** – Duke u përgjigjur për dhunën në familje, për shkak të mungesës së ligjeve - nuk qëndron dhe ka ligje që i rregullojnë këto fusha. I përmendi titujt e disa ligjeve dhe theksoi se nga praktika është vërejtur se mentaliteti kosovar ka lenë gjurmë të thella dhe kërkohet kohë për ta studiuar nga se është temë e ndjeshme.

**Ibrahim Makolli** – Për diskutimet e parafolësve shtoi: Nuk mund të thuhet se nuk ka ligje që e rregullojnë këtë fushë, por nuk ka ligj të veçantë për të drejtat e njeriut. Këtë fushë e rregullojnë dispozitat e ligjeve, si vijon: Në familje, në fushën e barazisë gjinore dhe të trashëgimisë - kishte dhunë, që në kohë të fundit ka shënuar rënie. Nëse i shikojmë statistikën, ato janë shqetësuese sepse janë të prekura të dy gjinitë. Nga kjo dhunë në radhë të parë pësojnë fëmijët dhe personat e moshuar. Shoqëria nuk është marrë me shkaktarët e dhunës, por me pasojat. Në këtë rast ripërsërisht jam kundërshtar i shtëpizave të sigurta, në të cilat viktimat e viktimizohen. E shoh të domosdoshme të merren masa për parandalimin e dhunës në familje. Si faktor tjetër, ngushtë i lidhur me të, është mungesa e mekanizmave të akteve nënligjore. Ndërkaq për pyetjen e emërimit të Avokatit të Popullit tha se Komisioni funksional për të Drejtat e Njeriut, ishte i përjashtuar nga intervistimi i kandidatëve për këtë funksion dhe këtë të drejtë e kishte Komisioni për Gjyqësi. Ai i paraqiti vërejtjet për formimin e panelit intervistues, duke e cekur se nuk ka njohuri për të drejtat e njeriut, por i ka intervistuar kandidatët. Në vazhdim të kësaj tha se në vitin 2006 ishte kandiduar për Avokat të Popullit, por me ndërhyrjen e politikës ka mbetur pa u zgjedhur. Pra, sipas tij, posti i Avokatit të Popullit, po politizohet duke pasur ndërhyrje të gjithanshme, duke i anashkaluar kriteret bazë të konkursit dhe duke i përzgjedhur kandidatët që nuk kanë përvojë në fushën e të drejtave të njeriut. Pra, kjo ka ndikuar të zbehet ky institucion në sytë e qytetarëve. Ky funksion nuk është i parëndësishëm dhe çdo qeveri dëshiron ta ketë afër vetes duke e pasur për bazë se raportet e tij kanë ndikim në qarqet ndërkombëtare. Sa u përket të drejtave të njeriut në Kosovë ka përparim në të gjitha rrafshet, por jemi larg standardeve ndërkombëtare.

Ishte konkludim i përgjithshëm që komunitetet të kenë të ardhme të përbashkët dhe t'i ofrohet ndihmë teknike Komisionit.

Ismet Beqiri i falënderoi mysafirët dhe tha që në të ardhmen të zhvillohen takime të këtij lloji.

Përgatitur nga ,

Rrahim Demaj - zyrtar i lartë ligjor

Kryetari i Komisionit  
Ismet Beqiri